



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**

**REZULTATI I SHORTIT TË HEDHUR
PËR ZGJEDHJEN E
ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI**

Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta përmes përfaqësuesve të Autorizuar me Autorizimin nr. 4153/3 Prot., datë 04.12.2020, në zbatim të plotë të detyrimeve Kushtetuese dhe ligjore, zhvilloi sot në datë **4 dhjetor 2020, ora 11:00** shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i cili e ushtron detyrën me një mandat një vjeçar. Mandati i këtij Këshilli ushtrohet prej datës 1 janar 2021 deri në 31 dhjetor 2021.

Shorti u hodh në prani të Avokatit të Popullit, znj. Erinda Ballanca, e cila monitoroi procesin së bashku me përfaqësues nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, zoti Alfred Balla, Këshilli i Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku, Gjykata Kushtetuese, zoti Ermal Tauzi, Kuvendi i Shqipërisë, zonja Mimoza Arbi, si dhe në prani të këshilltares ligjore rezidente pranë OPDAT, zonja Michelle Lakomy.

Në përfundim të hedhjes së shortit anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi që do të funksionojë përgjatë vitit 2021 janë:

1. **Marsida Xhaferllari** nga Gjykata Kushtetuese
2. **Elsa Toska** nga Gjykata Kushtetuese
3. **Ervin Pupe** nga Gjykata e Lartë
4. **Adnan Xholi** nga Prokuroria e Përgjithshme
5. **Astrit Kalaja** nga Gjykatat e Apelit
6. **Elona Toro** nga Gjykatat e Apelit
7. **Gjon Fusha** nga Zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit
8. **Genti Xholi** nga Zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit
9. **Rilinda Selimi** nga Gjykatat Administrative

Anëtarët Zëvendësues të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të zgjedhur me short me të njëjtën procedurë, janë si më poshtë:

1. **Fiona Papajorgji** nga Gjykata Kushtetuese
2. **Ilir Panda** nga Gjykata e Lartë
3. **Kujtim Luli** nga Prokuroria e Përgjithshme
4. **Zegjine Sollaku** nga Gjykata e Apelit
5. **Kleanth Zeka** nga Zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit
6. **Gentiana Xhelili** nga Gjykatat Administrative

Procedura e shortit filloi në orën 11:00 dhe përfundoi në orën 11:46.

Tiranë, 4 dhjetor 2020, ora 11:46.

**MIRATOI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

ORNELA ZONJA*

**Nëpërmjet Autorizimit Nr. 4153/3 Prot., datë 04.12.2020, të Presidentit të Republikës*

Sekretaria Teknike

Znj. Xhensjana Vathi

Z. Andi Hasani

Znj. Sindi Xhuglini